



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

**EURALIUS**  
Consolidation of the  
Justice System in Albania

### Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një përkthim dhe konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR VENDIM

### MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE TË DREJTESISË PËR TË MITUR

Në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 23, pika 4 dhe 7 të Ligjit Nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", nenit 3, pika 4 dhe 5, neneve 27, 28 dhe 140, pika 5 të Ligjit Nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

#### U D H Ë Z O N:

1. Në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit të juridiksionit të përgjithshëm duhet të caktohen së paku 3 gjyqtarë, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, nëse për shkak të numrit të gjyqtarëve në keto gjykata, nuk mund të krijohen për gjykimin e këtyre çështjeve, seksione të specializuara me së paku 6 gjyqtarë.
2. Kur numri i gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit të juridiksionit të përgjithshëm është më i vogël apo i barabartë me 3, të tre gjyqtarët duhet të caktohen për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.
3. Gjyqtarët e caktuar sipas pikës 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, sikundër edhe gjyqtarët e seksioneve për të mitur, me qëllim specializimin e tyre, duhet të ndjekin programet e trajnimeve vazhduese në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur.
4. Lista e gjyqtarëve të caktuar si më sipër dhe çdo ndryshim i saj, duhet t'i njoftohet Keshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përditësimin e listës së gjyqtarëve që specializohen në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur e trajnimin e vazhdueshëm të tyre.
5. Ngarkohen Këshillat e Gjykatave për zbatimin e këtij udhëzimi detyrues.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ministria e Drejtësisë,  
Bolevardi "Zogu I"  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 40 333  
E-mail: info@euralius.eu  
Web: www.euralius.eu

